


MISIONI KATOLIK SHQIPTAR – LUZERN




LUTJET THEMELORE

Luzern, dhjetor 2015

VITI I MËSHIRËS HYJNORE

Pjesë nga Bulla e shpalljes së Vitit të Jashtëzakonshëm të Mëshirës - Misericordiae Vultus (8 dhjetor 2015 – 20 nëntor 2016)



2. Gjithmonë kemi nevojë ta sodisim misterin e mëshirës. Është burim gëzimi, qetësie dhe paqeje. Është kusht për shpëtimin tonë.

Mëshirë, është fjala që zbulon misterin e Trinisë së Shenjtë. Mëshirë, është veprimi i fundit dhe më i madhi me të cilin Hyji na del përpara. Mëshirë: është ligji themelor që banon në zemrën e çdo personi kur shikon me sy të sinqertë vëllain që e takon gjatë

jetës. Mëshirë, është rruga që bashkon Hyjin dhe njeriun, sepse ia hap zemrën shpresës, se, jemi të dashur gjithmonë pa marrë parasysh kufizimin e mëkatit tonë.

3. ... Të e dielën e tretë në Kohën e Ardhjes, do të hapet Dera e Shenjtë në Katedralen e Romës, në Bazilikën e Shën Gjonit në Lateran. Pastaj, do të hapet Dera e Shenjtë në Bazilikat e tjera Papnore. Po atë të diel, caktoj që në çdo kishë të veçantë, në Katedrale që është kisha nënë për të gjithë besimtarët, apo edhe në Konkatedrale apo në një kishë me një domethënie të veçantë, të hapet gjatë gjithë Vitit të Shenjtë një Derë e

tillë e Mëshirës. Sipas zgjedhjes së Ipeshkvit, ajo mund të hapet edhe në Shenjtërore, vende ku shkojnë shumë shtegtarë, që në këto vende të shenjta, shpesh preken në zemër nga hiri dhe gjejnë rrugën e kthimit. Pra, çdo kishë e veçantë, do të jetë e përfshirë drejtpërsëdrejti për ta jetuar këtë Vit të shenjtë, si një moment të veçantë hiri e ripërtëritjeje shpirtërore. Prandaj, Jubileu do të kremtohet në Romë dhe në kishat e veçanta, si shenjë e dukshme e bashkimit të mbarë Kishës.

13. Duam ta jetojmë këtë Vit Jubilar, në dritën e fjalës së Zotit: Të Mëshirshëm si Ati... Pra, për të qenë të aftë për mëshirë në rend të parë duhet të vihemi në dëgjim të Fjalës së Hyjit. Kjo do të thotë të rikuperohet vlera e heshtjes për të medituar Fjalën që na drejtohet. Në këtë mënyrë është e mundur të soditet mëshira e Hyjit dhe të merret si stil jete.

25. ... Në këtë Vit Jubilar, Kisha u bëftë jehonë e Fjalës së Hyjit, që ushton fuqishëm dhe bindshëm si një fjalë dhe një gjest i faljes, i mbështetjes, i ndihmës, i dashurisë. Mos u lodhtë kurrë së dhuruari mëshirë dhe qoftë gjithmonë e durueshme në ngushëllim dhe falje. Kisha u bëftë zëri i çdo burri dhe gruaje dhe përsërit me besim dhe pa pushim: «Të të bien në mend mëshirat e tua, o Zot, dhe dashuria jote që është e amshueshme» (Ps 25,6).

Papa Françesku

ZOJA E KËSHILLIT TË MIRË

Pajtores e Misionit në Luzern
(Festa më 26 prill)



“E lumja ti që besove, se do të plotësohet çka të qe thënë prej Zotit!” (Lk 1, 45)

Sikur në mbarë Kishën, ashtu edhe ndër ne, për Zojën e bekuar është i përhapur një devocion i madh që na shërben jetën tonë shpirtërore.

Maria na mëson se për ta njohur Krishtin apo për të hyrë në misterin e Tij, do të thotë duhet tu shërbesh të tjerëve me atë dashuri me të cilën Krishti i shërbej apostujt e vet.

Festa e Zojës së Këshillit të Mirë na nxitë që edhe më tepër t'i përngajmë jetës së saj, ta marrim për shembull jete, se si duhet të jemi dëgjues e zbatues të Fjalës së Zotit, me çfarë duresë e dashurie të vihemi në shërbim të asaj çka Zoti kërkon prej nesh.

Duke marrë para sysh se „Zoja e Këshillit të Mirë“, e njohur si “Zoja e Shkodrës”, është edhe “Pajtorja e Shqiptarëve”, Misioni në Luzern e ka zgjedhur për Pajtores të veten, duke i kushtuar të gjitha familjet nën mbrojtjen e Saj.

Zoja e Këshillit të Mirë që nderohet në popullin tonë që prej kohërave të lashta dhe historia e saj që është e

lidhur me historinë e krishterimit shqiptarë, sidomos me emigrimin e shqiptarëve gjatë sundimit otoman, është festë që bashkon shqiptarët. Le t'i kushtohemi çdo ditë e më shumë dhe ta ruajmë miqësinë e shenjtë me Të.

Lutja

O Hyj, ti na dhe për nënë Nënë e Birit tënd fort të dashur dhe figurën e saj e qite në pah me dukuri të mrekullueshme: bëj, po të lutemi, që ne, të drejtuar prej këshillave të saja, të jetojmë sipas dëshirës së Zemrës sate dhe të kemi fatin të arrijmë në mbretërinë qiellore.



Festa e Zojës së Këshillit të Mirë
Emmenbrücke, prill 2015

BEKIMI I SHTËPIVE DHE FAMILJEVE

Të dashur besimtarë,

Një nga aktivitetet tona të rëndësishme pastorale, edhe këtu në mërgim, pa dyshim, është bekimi i shtëpive dhe familjeve. Këto vizita, mbi të gjitha, kanë për qëllim të na forcojnë lidhjen tonë me Zotin i cili na bekon.

Marrë para sysh rrethanat dhe hapësirën territoriale që mbulon Misioni ynë, po mundohemi të arrijmë në secilën familje, që së bashku, ta lëvdojmë Zotin dhe të kërkojmë ndihmën dhe bekimin e tij. *“Hir, mëshirë dhe paqe prej Hyjit Atë, dhe prej Krishtit Jezus, Zotit tonë”* (Ef 1, 2).

Me rastin e bekimit gjatë këtij viti (2016), po Ju dhurojmë këtë fletushkë modeste me lutjet themelore, në mënyrë që, këtë thesar shpirtëror të vazhdojmë ta ruajmë dhe kultivojmë në gjuhën tonë amtare.

Me porosinë më të përzemërt që këto lutje t’u shoqërojnë çdo ditë gjatë gjithë jetës, për një formim të mirëfilltë shpirtëror, sidomos të fëmijëve dhe të brezave të rinj, Ju uroj mbarësi dhe bekime në jetën Tuaj.

BEKIMI DHE PËRVOJA E KRISHTERË

Shpesh kemi raste kur besimtarët kërkojnë bekime, qoftë për fëmijë apo për të sëmurë, lutje e bekime për nevoja të tyre, bekimin e gjësendeve të natyrave të ndryshme: bekimin e kryqit, qiriut, ushqimeve etj.

Çka do të thotë bekimi? Nga fjala latine bene-dicere-të thuash mirë për dikë ose për diçka, të kërkosh prej Zotit të mira. Është një lavd Zotit për të fituar ndihmë dhe mbrojtje prej tij. Shën Pali, i ndërlidh dy bekimet, atë të lavdërimit të Emrit të Zotit dhe bekimin e Zotit ndaj nesh duke thënë: *"Qoftë bekuar Hyji. Ati i Zotit tonë Jezu Krishtit, i cili na bekoji me çdo bekim shpirtëror në qiell në Krishtin"* (Ef 1, 3).

Bekimi nuk është sakrament por sakramentor. «Kisha Nënë e shenjte i ka themeluar sakramentorët. Këto janë shenja të shenjta, një mënyrë e imitimit të sakramenteve, të cilat shprehen me lutjen e Kishës dhe arrihen efekte kryesisht shpirtërore. Me anë të tyre njerëzit përgatiten për të marrë efektin kryesor të sakramenteve dhe shenjtërohen rrethanat e ndryshme të jetës» (KKK 1667).

Pra, për ta kuptuar më mirë dallimin në mes sakramenteve dhe sakramentorëve na ndihmon Katekizmi i Kishës Katolike ku thuhet: Sakramentor quhen shenjat e shenjta të themeluara nga Kisha, qëllimi i të cilave është t'i përgatitin njerëzit për të marrë frytin e sakramenteve. (KKK 1677).

Ndër sakramentorët më të parat, janë bekimet. Edhe atë: të personave, të tryezës, të sendeve, të vendeve etj. Çdo bekim është lavdërim i Hyjit dhe lutje për të pasur dhuratat e tij. Në Krishtin, të krishterët bekohen nga Hyji Atë *«me çdo bekim shpirtëror»* (Ef 1, 3). Prandaj Kisha e jep bekimin duke thirrur emrin e Hyjit dhe duke bërë normalisht shenjën e shenjtërueshme të kryqit të Krishtit (1671).

Zakonisht, bekimet janë të përcjella përherë me lutje, lexim të ndonjë pjese nga Fjala e Zotit, gjeste, siç është

shtrirja e duarve, shenja e Kryqit dhe spërkatja me ujë te bekuar.

Në Ungjill, lexojmë se si Jezusi i bekon fëmijët: *“Atëherë i përqafoi fëmijët dhe i bekoj duke vënë duart mbi ta”* (Mk 10, 16), pastaj ushqimet: *“I mori pesë bukët e dy peshqit, i çoi sytë kah qielli, i bekoj, i ndau dhe ua dha nxënësve, kurse nxënësit turmës”* (Mt 14, 19).

Gjatë historisë së Kishës janë zhvilluar rite e formula bekimesh edhe atë që nga shekulli i parë, si në liturgji, ashtu edhe jashtë saj, përherë të përcjella me shenjën e Kryqit.

Pra, formula e bekimit mbi të gjitha shpreh falënderimin tonë Zotit për të gjitha të mirat që na jep, por edhe lutje që të na ndihmoj dhe të na mbroj nga çdo e keqe.

Në këtë kontekst, edhe para Krishtit, njerëzit janë përpjekur që përmes shenjave dhe shprehjeve të ndryshme t'i mbajnë larg shpritrat e këqinj. Ndërsa, në botën tonë të krishterë bekimi ka edhe kuptimin e një marrëdhënieje të veçantë me Zotin.

Përveç njerëzve, bekohen objekte, vende, fusha, kafshë, mjete të punës etj. Kjo e shpreh kujdesin e Hyjit për tërësinë e jetës njerëzore, i cili, përmes Kishës vazhdon veprën e shëlbimit.

Në traditat dhe kulturat e popujve të ndryshëm, dallon edhe koha, sezoni dhe mënyra e bekimit të familjeve dhe shtëpive. Në disa vende bëhet para Pashkëve ose gjatë kohës së Pashkëve. Kjo sepse bazohen në kremtimin e Pashkëve hebreje që ndërlihet me qengjin e flijuar. Në librin e Daljes

lexojmë: *“Le të marrin prej gjakut të tij dhe le t’i lyejnë të dy shtalkat dhe ballzinat e dymëve të shtëpive, në të cilat do ta hanë qengjin (Dal 12, 7). Kjo do të jetë shenjë dalluese që Zoti ta kursej atë shtëpi nga dënimi: “Gjaku do t’ju shërbejë si shenjë se në cilën shtëpi jeni: unë do ta shoh gjakun dhe ju do t’ju kaloj” (Dal 12, 13). Pastaj, si kohë e përshtatshme për bekimin e shtëpive, në ritin ambrozian merret koha e Ardhjes, e cila zgjatë gjashtë javë e jo katër si në ritin romak. Kjo kohë e shenjtë përgatitë besimtarët për takim me Krishtin. Foshnjës së Betlehemit ia hapim zemrën dhe shtëpitë tona për bekim.*

Në botën gjermane si dhe vende tjera skandinave, angleze etj., të ashtu quajturit “Sternsinger”, fëmijë të veshur si mbretër, në mes datës 25 dhjetor deri më 6 janar, në mënyrë të organizuar vizitojnë familjet në lagjet e tyre. Këndojnë këngë Krishtlindjesh dhe bashkë me familjet luten për një vit të mbarë.

Më pas, në dymë ose mbi to shënohen tri incialet e tre Mbretërve, simboli i Kryqit dhe viti pasues. Numrin tre, Origjeni e ndërlidh me tri dhuratat që Mbretërit sollën para Krishtit në Betlehem, ar, kem dhe mirrë. Po ashtu flet për tre Mbretërit: Caspar, emri me prejardhje persiane, Melkior me prejardhje hebreje dhe Baltazar, emër babilonas. Tri incialet kanë interpretime të ndryshme. Një prej tyre kryesore lidhet me shprehjen latine, dhe shënohet kështu, psh: 20 + C + M + B 16 Christus mansionem benedicat – Krishti e bekoftë këtë shtëpi.

Në Zvicër, prej vitit 1989 “Sternsingen” ka marrë gjallëri dhe udhëhiqet nga Missio (Shoqëri papnore për vendet misionare në botë - missio.ch). Me këtë

rast ndihmohet fondi solidar “Fëmijët ndihmojnë fëmijët”.

Në popullin tonë është bërë traditë që bekimi i familjeve dhe shtëpive të bëhet pas festës së Dëftimit (Tre Mbretërit – Dita e ujit të bekuar).

Mirëpo, pa marrë para sysh origjinën e këtij gjesti, apo periudhën e bekimit, një gjë është e rëndësishme: Jezusi, përmes Kishës së vet, vjen dhe na viziton për të na sjellë gëzim dhe paqe të cilën mund të na e jep vetëm Ai. Në Ungjillin e Lukës lexojmë fjalët e Krishtit që na porositë: *“Në cilëndo shtëpi të hyni, më parë thoni: ‘Paqja me këtë shtëpi!’* (Lk 10, 5).

Kjo paqe e Krishtit mbretëroftë përherë në zemrat dhe familjet Tuaja!

Don Agim Qerkini,
misionari Juaj

BEKIMI I SHTËPISË OSE BANESËS

(Riti dhe lutja e bekimit)

M. Ndihma jonë është në emër të Zotit.

P. I cili krijoi qiellin e tokën.

M. O Zot, dëgjoje lutjen time.

P. E britma ime le të vijë te ti.

M. T'i lutemi Hyjit, Atit tonë: Për të gjithë anëtarët e kësaj familjeje, që ta çmojnë dhe ta kuptojnë njëri-tjetrin, që t'i ndihmojnë njëri tjetrit me këshillë e vepër, si dhe të rriten së bashku në fe, shpresë dhe dashuri. (Lutja në heshtje)

M. O Zot, ki mëshirë.

P. O Zot, ki mëshirë.

M. O Krisht, ki mëshirë.

P. O Krisht, ki mëshirë.

M. O Zot, ki mëshirë.

P. O Zot, ki mëshirë.

M. Të lutemi për fqinjët, miqtë dhe dashamirët e kësaj familjeje, që të përpiqen të jetojnë në paqe dhe të kujdesen për njëri-tjetrin, të lutemi.

P. Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë.

M. Për të gjithë ata që kërkojnë strehim, për ata që jetojnë larg vendlindjes së tyre, për të vetmuar, të sëmurë dhe për ata që vuajnë ndër ngushtica, që mos ta humbin shpresën në Zotin dhe në njerëzit, por ta gjejnë ndihmën dhe ngushëllimin, të lutemi.

P. Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë.

M. Për të vdekurit e kësaj familjeje N. N. dhe për të gjithë ata me të cilët kemi pasur lidhje kur ende ishin

gjallë: që tani ta njoftojnë mirësinë e Hyjit dhe të marrin pjesë përgjithmonë në paqen e tij, të lutemi.

P. Dëgjoje, o Zot, lutjen tonë.

M. Tash këto lutje t'i bashkojmë me lutjen të cilën Krishti ua mësoi nxënësve të vet: Ati ynë, që je në qiell...

Bekimi

M. O Zot, Hyj i gjithëpushtetshëm, prej teje, nëpër ty dhe në ty është çdo gjë. Mbage dorën tënde bekuese mbi këtë shtëpi. Falu të gjithëve që jetojnë në këtë shtëpi shpirtin e dashurisë sate. Ji afër atyre që kanë hyrje e dalje në këtë shtëpi. Zoti bëftë që fytyra e tij të shndrisë mbi ju dhe pastë mëshirë për ju! Ai e ktheftë fytyrën e vet kah ju dhe ua dhashtë paqen!

E ju bekoftë ju dhe këtë shtëpi (banesë) Hyji i gjithëpushtetshëm, Ati e Biri e Shpirti Shenjt.

P. Amen.

20 + C + M + B 16
Christus mansionem benedicat
Krishti e bekoftë këtë shtëpi!



LUTJET THEMELORE

SHENJA E KRYQIT

Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen.

LUTJA ATI YNË

Ati ynë, që je në qiell,
u shenjtëroftë emri yt,
ardhtë mbretëria jote,
u bëftë vullnesa jote,
si në qiell ashtu në tokë.
Bukën tonë të përditshme,
na e jep ne sot.
Na i fal fajet tona,
si i falim ne fajtorët tanë.
E mos na lër të biem në tundim,
por na liro nga i Keqi. Amen.

TË FALEMI MARI

Të falemi Mari, hirplote, Zoti me ty, e bekuar je mbi të gjitha gratë dhe i bekuar fryti i barkut tënd, Jezus. Shenjta Mari, Nëna e Tenzot, lutu për ne mëkatarët, tash e në fill të vdekjes sonë. Amen.

LAVDI ATIT

Lavdi Atit e Birit e Shpirtit Shenjt.
Si ka qenë në fillim, ashtu tash e përgjithmonë e jetës.
Amen.

ENGJËLLI I ZOTIT

Engjëlli i Zotit iu fal Zojës Mari;
e ajo ngjizi për virtyt të Shpirtit Shenjt.
Të falemi Mari...

Ja shërbëtorja e Hyjit;
u bëftë me mua si është fjala jote.
Të falemi Mari...

E Fjala u bë njeri; e banoi ndër ne.
Të falemi Mari...

Lutu për ne, o e shenjtja Nënë e Hyjit;
të bëhemi të denjë për premtimet e Jezu Krishtit.

Të lutemi: Hirin tënd, po të lutemi, o Zot, ndikoje në
shpirtin tonë, që sikurse në lajmërimin e engjëllit na e
zbulove mishërimin e Birit tënd, Jezu Krishtit, nëpër
mundime e kryq të tij na udhëhiq në lavdinë e
ringjalljes. Nëpër Krishtin Zotin tonë.

Amen.

MBRETËRESHË E QIELLIT

Mbretëreshë e qiellit, gëzohu, Aleluja.
Se ai që meritove për ta bartur, Aleluja.

U ngjall si pati thënë, Aleluja.

Lute për ne Hyjin, Aleluja!

Gëzohu e galdo, Virgjëra Mari, Aleluja.

Zoti u ngjall me të vërtetë, Aleluja.

Të lutemi: O Zot, që nëpër ngjalljen e Birit tënd, Jezu
Krishtit, u denjove ta ngushëllosh botën, bëj që nëpër
Nënë e tij, Virgjërën Mari, të fitojmë ngushëllimet e
jetës së amshuar. Nëpër Krishtin, Zotin tonë. Amen.

PUNËT E NEVOJSHME PËR T`U RRËFYER MIRË:

1. Kujto të gjitha mëkatet që i ke bërë!
2. Pendohu për të gjitha mëkatet që i ke bërë!
3. Jepja fjalën Zotit se nuk do të mëkatnosh më!
4. Tregoji rrëfyesit të gjitha pa rrena!
5. Bëje pendesën që ta jep rrëfyesi!

PUNËT E NEVOJSHME PËR T`U KUNGUAR MIRË:

1. Të jesh në hir të Zotit pa mëkat të rëndë.
2. Një orë para kungimit ndalohet çdo ushqim e pije.
3. Beso se po e merr Krishtin në zemër.

PUNA E PENDIMIT

Puna e pendimit, o Zotit im, po më vjen keq me gjithë zemër për të gjitha mëkatet që i kam bërë, që kam bjerrë parrizin e kam merituar ferrin, por ma fort se të kam fye ty, o e mira e pambarume, që kaq fort më ke dashtë. Mëshirë o Zot, më falë o Zot! Po ta jap fjalën se me ndihmën tënde s`kam me të fye ma kurrë. Ashtu qoftë.

SAKRAMENTET:

Pagëzimi

Krezmimi (Përforcimi)

Kungimi

Rrëfimi

Vajimi

Urdhri Shenjt

Kurora e martesës

DHJETË URDHËRIMET E ZOTIT:

Unë jam Zoti yt. Tjetër Zot mos të kesh e mos të adhurosh pos meje!

Mos e merr emrin e Tenzot nëpër gojë kot!

Shenjtëro ditën diel e ditën festë të urdhëruar!

Ndero prindin tënd në daç të jetosh shumë përmbi dhe!

Mos vraj!

Mos kurvëro!

Mos vidh!

Mos bëj dëshmi në rrenë!

Mos lakmo njeriun e huaj për të keq!

Mos lakmo kurrnjë gjë të huajën!

VIRTYTET HYJNORE

Feja, Shpresa, Dashuria

BESOJMA APOSTOLIKE

Besoj në Hyjin, Atin e gjithëpushtetshëm, Krijuesin e qiellit e të tokës. Besoj në Jezu Krishtin, Birin e tij të vetëm, Zotin tonë, i cili u zu për virtyt të Shpirtit Shenjt. Lindi prej Virgjërës Mari, pësoi mundimet nën Poncin Pilat, u kryqëzua, vdiq e u varros, zbriti në mbretërinë e vdekjes, të tretën ditë u ngjall së vdekurve; u ngjit në qiell, rri në të djathtën e Atit të gjithëpushtetshëm; prej aty do të vijë për të gjykuar të gjallët e të vdekurit. Besoj në Shpirtin Shenjt, Kishën e shenjtë katolike, shoqërinë e shenjtërve, faljen e mëkateve, ngjalljen e trupit, jetën e pasosur. Amen.

SHPIRTIT TË SHENJTË

Dhuratat e Shpirtit Shenjt:

Urtia
Kuptimi
Këshilla
Forca
Dija
Përshpirtëria
Frika e Tenzot



EJA O SHPIRT KRIJUES

O Shpirt Shenjt deh
zbrit mbi ne, e prej
qielli derdh mbi ne,
rrezet tua plot me
dritë.

Eja o At' për nevojtarë,
eja Ti n'dhanti bujar,
eja Ti që mendjet
shndrit.

Ti n'ngushtica
ngush'llim bjen, ti ndër
zemra si mik vjen,
t'lodhun n'jetë rishtas
forcon.

N'mund e djersë Ti je
pushim, n'vapë e luftë
Ti je freskim, lot ti terë
zemrat ngushllon.

Dritë hyjnore plot
shenjtni,
shndritnaj mendjet
n'dashuri,
kalle flakë kë n'ty
shpreson.

Ku s'je Ti gjithçka
dështon,
n'natyrë t'njerit gjë
s'qëndron, që t'jetë
shenjte si Ti don.

Njollat hiq, dangat
pastro,
n'shpirit'rat tanë hiret
rigo,
varr't e m'katit na i
shëro.

Jepna ne që n'Ty
besojmë,
jepna ne që n'Ty
shpresojmë, shtatë
dhantitë që aq
dësh'rojmë.

Çka është t'brishtë
kandshëm lako, çka
është t'ftoftë me flakë
rretho,
çka është shtrembtë
ëmbël drejto.

Mundin tonë Ti na
shpërble,
n'm'kat me vdekë Ti
mos na le, ban me Ty
n'amshim t'lumnojmë.
Amen.

LUTJA E MËNGJESIT

O Zoti im, po të falënderoj që më ke ruajtur sonte. Në fillim të kësaj dite të lutemi që t'na ruajsh me fuqinë tënde. Na largo nga çdo rrezik dhe nga çdo e keqe. Na ndihmo që mendimet, bisedat dhe veprat tona të përshtatën sipas dëshirës sate. O Zoti im, po ta japë fjalën që me ndihmën tënde do të mundohem sot që të mos fyej me kurrnjë mëkat. O Zoti im, gjithçka të bëj e gjithçka të vuaj në këtë ditë, dua ta bëjë për hatër dhe për dashuri ndaj Teje.

O Zot i gjithëpushtetshëm, që na ke dhënë fatin ta presim edhe këtë ditë, na ruaj me pushtetin tënd, që sot mos të biem në kurrnjë mëkat, por le të rrjedhin dhe le të drejtohen mendimet dhe veprat tona për të kryer përherë vullnetin tënd. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Zemra e Krishtit Zotit tonë,
bëj që ty të duam gjithmonë.
Zemra e Zojës nënës sonë,
qofsh ti shëlbimi ynë.

Engjëlli i Zotit që je rojësi im, pasi Zoti ynë, për
mëshirë të vet ta ka lënë ty në rojë, ti sot më shndrit,
më mbaj, më ruaj e më sundo. Ashtu kjoftë.

LUTJA E MBRËMJES

O Zot, dita po përfundon. Unë po e përkujtojë ditën që
kalojë, jetën time në rrugë, në dhomë, në tavolinë.
Posaqërisht po mendoj në njerëzit në rrugë, në
njerëzit në dhoma, në njerëzit nëpër tavolina. Unë
kam biseduar dhe kam qeshur me ta. Kam punuar dhe
kam ngrënë me ta. Unë jam takuar dhe i kam
nervozuar. Unë i kam ngushëlluar dhe i kam dashur.
Krejt çka kam bërë, ta kam bërë ty o Zot. Më fal për
faje, më ngushëllo dhe qëndro përherë në jetën time.
Po të lutemi o Zot, eja në banesën tonë e dëboj larg
nesh të gjitha pritat e armikut; engjëjt e shenjtë le të
banojnë në banesën tonë dhe le t`na ruajnë në paqe të
vërtet. Dhe bekimi yt qoftë gjithmonë me ne. Nëpër
Krishtin Zotin tonë. Amen.

Jezu Krisht, shenjta Mëri, shenjti sh`Jozef,
juve po ju fali zemrën e shpirtin tim.
Jezu Krisht, shenjta Mëri, shenjti Sh`Jozef,
ju më dilni zot në çast të vdekjes sime.
Jezu Krisht, shenjta Mëri, shenjti sh`Jozef
Në paqe me ju qoftë vdekja ime. Amen.

PARA BUKE

Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen.

Ati ynë... Bukën tonë...



Jepna, o Zot, bekimin tënd ne dhe këtij ushqimi që po e marrim prej mirësisë sate. Nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen

PAS BUKE

Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen.

Po të falemi nderës, o Zoti i gjithëpushtetshëm dhe i amshuar, për të gjitha të mirat që na dhurove. Ti që jeton e sundon në shekuj të shekujve. Amen.

FAMILJES SË SHENJTË

O Familje e Shenjtë e Nazaretit, bashkësia e dashurisë së Jezusit, Marisë dhe Jozefit, model ideal për çdo familje të krishterë, ty po t'i besojmë familjet tona. Hapi ndaj fesë zemrat e familjeve, për pranimin e Fjalës së Hyjit dhe për të dhënë dëshmi të krishterë, në mënyrë që ato të bëhen burim thirrjesh të reja dhe të shenjta.

Drejtoje mendjen e prindërve, që me dashuri të përkujdesshme, me vëmendje të ditur dhe me ndrojtje

të ndjeshme, të jenë për fëmijët e tyre drejtues të sigurtë kah të mirat shpirtërore dhe të amshueshme. Ngjalle në të rinjtë një ndërgjegje të drejtë dhe një vullnet të lirë, në mënyrë që duke u rritur “në dije, pjekuri dhe hir”, ta pranojnë me guxim dhuratën e thirrjes së Hyjit.



O Familja e Shenjtë e Nazaretit, bëj që të gjithë ne, duke kundruar dhe imituar mënyrën tënde të jetesës në lutje të zellshme, dëgjese të lirë, varfëri plot dinjitet dhe pastërti virgjërore, të jemi të gatshëm për të kryer vullnetin e Hyjit dhe të shoqërojmë me zgjuarsiri të matur ata që mes nesh janë të thirrur për të

ndjekur sa më afër Jezu Krishtin, i cili “për ne dhuroi vetveten” (krh Tt,2,14) Amen!

Papa Gjon Pali II

Vatikan, 26 dhjetor 1993, në festën e Familjes së Shenjtë.

SHPIRTI I KRISHTIT

Shpirti i Krishtit më shenjtëro mua,
Korpi i Krishtit më shëlbo mua,
Gjaku i Krishtit më ngij mua,
uji i kraharorit të Krishtit më pastro mua.
Mundimi i Krishtit më forco mua,
o i ëmbli Jezus më dëgjo mua,
ndër plagët e tua më fsheh mua,
mos lejo të ndahem prej teje,
prej armikut të shpirtit më del Zot mua,
në fill të vdekjes sime ti më thirr mua.
Bëj që unë të vij tek ti,
e me shenjtër të lëvdoj ty,
përgjithmonë e jetës. Amen.





RRUZARJA E SHENJTË

SHENJAT E GËZIMIT

(Për të hënë dhe të shtunë)

1. Në të parën shenjë të gëzimit të mendojmë se Zoja e bekuar që përshëndetur prej engjëllit Gabriel, pse prej saj do të zinte fill dhe do të lindë Shëlbuesi ynë Jezu Krishti.
(Thuhen: 1 Ati ynë, 10 Të Falemi Mari dhe Lavdi Atit)
2. Në të dytën shenjë të gëzimit të mendojmë se Zoja e bekuar shkoi të takohet me shenjtën Elizabetë dhe ndenji me të tre muaj.
3. Në të tretën shenjë të gëzimit të mendojmë se, kur erdhi koha të lindë Jezu Krishti, lindi prej Virgjërës Mari në Betlehem.
4. Në të katërtën shenjë të gëzimit të mendojmë se Jezu Krishti, kur u bë 40 ditësh, që dërguar dhe kushtuar në shenjtëroren e Jeruzalemit.
5. Në të pestën shenjë të gëzimit të mendojmë se Jezu Krishti, dymbdhjetëvjeçar që gjetur të tretën ditë në shenjtërore të Jeruzalemit.

Në mbarim të çdo dhjetëshe, pas Lavdi Atit... mund të shtohen edhe këto dy thirrje: - Qoftë lavdëruar e nderuar Zoja e bekuar, Nëna e Tenzot, zënë pa faj e mëkat të rrjedhshëm. - O jezu im, na i fal mëkatet tona, shpëtona prej flakës së ferrit, dhe çoi në qiell të gjithë shpirtrat, por sidomos ata, që kanë më shumë nevojë për mëshirën tënde.

Rruzarja përfundon me: Të falemi Mbretëreshë.

TË FALEMI, MBRETËRESHË

Të falemi, Mbretëreshë, Nëna e mëshirës, jeta, ëmbëlsimi e shpresa jonë, të falemi! Ty të thërrasim ne të shkretët, bijtë e Evës, që po fshajmë, po gjëmojmë e po qajmë në këtë shekull plot me lot. Deh pra, pajtorja jonë, ata sy të mëshirshëm të tu silli prej nesh! E Jezusin, të bekuarin, frytin e barkut tënd, pas kësaj shkretie na e kallëzo. O e dhimbshmja, o e buta, o e ëmbla Virgjëra Mari! Amen.

SHENJAT E MUNDIMIT

(Për të martën dhe të premtën)

1. Në të parën shenjë të mundimit të mendojmë se Jezu Krishti duke u lutur në kopsht të Gjetsemanit u djersit gjak. (Thuhen: 1 Ati ynë, 10 Të Falemi Mari dhe Lavdi Atit)
2. Në të dytën shenjë të mundimit të mendojmë se Jezu Krishti qe lidhur e rrahur në oborr të Pilatit.
3. Në të tretën shenjë të mundimit të mendojmë se Jezu Krishti qe kurorëzuar me ferra.
4. Në të katërtën shenjë të mundimit të mendojmë se Jezu Krishti me Kryq në krah u ngjit në mal të Kalvarit.
5. Në të pestën shenjë të mundimit të mendojmë se Jezu Krishti vdiq i gozhduar në kryq në mal të Kalvarit.

SHENJAT E DRITËS

(Për të enjten)

1. Në të parën shenjë të dritës të mendojmë se, kur Jezusi u pagëzua në lumin Jordan, na u zbulua si Biri i Zotit.
2. Në të dytën shenjë të dritës të mendojmë se, Jezu Krishti na e zbuloi hyjninë e vet duke bërë mrekullinë e parë në Kanë të Galilesë.
3. Në të tretën shenjë të dritës të mendojmë se Jezu Krishti na thirri në kthim dhe na e shpalli Mbretërinë e Zotit.
4. Në katërtën shenjë të dritës të mendojmë se, Jezu Krishti na e tregoi lavdinë e vet gjatë shndërrimit në malin Tabor.
5. Në pestën shenjë të dritës të mendojmë se, Duke e themeluar Eukaristinë e shenjtë, Jezu Krishti na bëri pjesëtarë të mundimit dhe të ngjalljes së vet.

SHENJAT E LUMTURISË

(Për të mërkurë, të shtunë dhe të diel)

1. Në të parën shenjë të lumturisë të mendojmë se Jezu Krishti ditën e Pashkëve është ngjallur së vdekuri.
2. Në të dytën shenjë të lumturisë të mendojmë se Jezu Krishti 40 ditë pasi është ngjallur, u ngjit në qiell ditën e Shëlbimit.
3. Në të tretën shenjë të lumturisë të mendojmë se Jezu Krishti dhjetë ditë pasi u ngjit në qiell, çoi Shpirtin Shenjt mbi apostujt ditën e Rrëshajëve.

4. Në të katërtën shenjë të lumturisë të mendojmë se Zoja e bekuar që ngjitur në qiell me korp dhe me shpirt.

5. Në të pestën shenjë të lumturisë të mendojmë se Zoja e bekuar që kurorëzuar Mbretresha e qiellit dhe e tokës, dhe të mendojmë edhe lumturinë e të gjithë engjëjve dhe shenjtërve.



“Zoja Ndhimëtare”, Prizren

UDHA E KRYQIT




Lutja Hyrëse

Në emër të Atit e të Birit e të Shpirtit Shenjt. Amen

O i miri dhe i dashuri Jezu Krisht, për dashurinë që kemi për Ty, duam t'i përcjellim me mend mundimet dhe vdekjen tënde në mal të Kalvarit. Ki dhimbë për ne, mekatarët e shkretë, mëkatët e të cilëve kanë qenë shkaku i mundimeve dhe vdekjes sate. Këtë përkushti po e paraqësim për nderim të emrit tënd, për nevojat tona shpirtërore, për freskim të shpirtit të purgatorit, si dhe për nevojat e Kishës shenjte. Amen.

Rrinte Zja tui lotue
afër krygjet, tui shikjue
Krishtin pezull kryqëzue.

*Nana e dashtun, t' lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT I

Jezu Krishtin e gjykojnë për vdekje

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Jezu Krishti, vetë pafajësia, gjykohet për vdekje. E pse? Që të na shpërblej padrejtësitë, gabimet dhe fajet tona, dhe që të na shlyejë gjykimin për ferr.


Lutja: O i dashuri Jezu Krisht, për mundimet që hoqe duke pranuar gjykimin e vdekjes së parrugë, na e shlyej edhe ne gjykimin e dënimit të amshuar që kemi merituar me mëkatet tona. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Heshta zemren prej trishtimit,
Prej ezgjetit, prej idhnimit,
Zoj's përshkue ia kishe shqimit.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT II

Jezu Krishtin është ngarkuar me kryq

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Jezu Krishti merr kryqin në krah dhe bashkë me kryq edhe të gjitha mëkatet e njerëzimit, për të cilat ka për të vdekur në mal të Kalvarit.

Lutja: Jezu Krisht, Shëlbuesi ynë, ti po e merr kryqin prej dashurisë që ke për ne. E ne fatzezët ende jemi duke mëkatnuar. Dëshirojmë me gjithë zemër të rrëfhehi dhe të pajtohemi me ty. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

O sa n'vaj e sa n'ankim

Kje nat çast, pa pas një g'zim

Nana e Krishtit veq bekim.

Nana e dashtun, t'lus pa pra,

varrët e Birit tënd pa da

Gjurma në zemër me m'i ba.



TË NDALURIT III

Jezu Krishti bie të parën
herë nën kryq

*V. T'adhurojmë, o Krisht, e të
bekojmë.*

*R. Pse me kryqin tënd të
shenjtë e shpërbleve botën
mbarë.*

Sa të rënda janë mëkatet
tona, kur nën barrën e tyre
rrëzohet Ai, që gjithçka mban me të pushtetshmen
doren e vet. E përse Jezu Krishti rrëzohet? Që të na çoj
ne prej llomit të mëkatëve.

Lutja: Jezu Krisht i dashur, mëkatet tona bërën që të
bijsh për dhe. Po të lutemi na jep lot t'i qajmë me
gjithë zemër, na jep fuqi që të japim besën dhe mos të
biem më kurr në to.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Kjant'e dneste e dhimbshmja Nanë,
Mundue Krishtin për gjithë anë,
Pa mujtë kush nji ndihmë me i dhanë.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT IV

Jezu Krishti has në Nënë e vet

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Jezu Krishti i gjykuar për vdekje, me kurorë ferrash në krye, me kryq në krahë, i rrahur prej mizorëve, has në Nënë e vet, Zojën e bekuar. Sa dhembje të madhe do të kenë sprovuar këto dy zemra të pastra dhe të dashura!

Lutja: Jezu Krisht i dashur, për dhembjen që sprovove kur hase në Nënë tënde, bën që edhe ne të kuptojmë rëndësinë e vuajtjeve. O Zojë, të jesh Ti Nëna jonë dhe bën të kthehemi kah Zoti dhe ti mbajmë urdherimet e tija. Amen

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Tue kqyrë Nanën e Tenzot
Afër Krishtit me varrë plot
Nuk asht njeri që s' derdhë lot.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da,
gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT V

Jezu Krishti ndihmuar prej
Cireneut

*V. T'adhurojmë, o Krisht, e
të bekojmë.*

*R. Pse me kryqin tënd të
shenjtë e shpërbleve botën
mbarë.*

Jezu Krishti aq fort është lodhur, sa nuk është më i zoti të bajë kryqin, por lypset që t'ia bajë njëfarë Simoni prej Cirenet. Gjithkush i ndihmon Jezu Krishtit kur i ndihmonë të afërmit që ka nevojë.

Lutja: Jezu Krisht i dashur, e dimë se duke mos u ndihmuar skamnoreve, nuk të kemi ndihmuar Ty në bartjen e kryqit. Na ndihmo që tash e tutje të duam gjithkënd për dashurinë tënde, e veçanërisht të vobektit dhe të mjerët. Amen

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Kush sheh Zojën n'at ezgjet,
Gati dekun për djalë të vet,
Pa dnesue, jo, nuk jet.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT VI

Veronika ia fshinë fytyrën
Jezu Krishti

*V. T'adhurojmë, o Krisht, e
të bekojmë.*

*R. Pse me kryqin tënd të
shenjtë e shpërbleve botën
mbarë.*

Jezu Krishti i lodhur dhe i mbetur i ngjitet malit të Kalvarit. Fytyra e tij është mbuluar me djersë, gjak dhe pluhur. Në mes të atyre që ngiheshin në mundime të Krishtit, u gjet një grua trimëreshë, e cila, pa marre edhe frikë prej salvuesash, i afrohet Jezu Krishtit dhe ia fshiu fytyrën e tij.

Lutja: E madhe që trimëria dhe e flaktë dashuria e së lumës Veronikë për Ty, o i dashuri Jezu Krisht! Bën, po të lutemi, që edhe ne të trimërohemi kah shpirti dhe pa marre ti kryejmë të gjitha urdhërimet e tua.
Amen

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Mëkatet tona me i resitë,
E pa Krishtin gjith molit,
Prej së rrahnash t'asaj ditë.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da,
gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT VII

Jezu Krishti bie të dytën
herë nën kryq

*V. T'adhurojmë, o Krisht, e
të bekojmë.*

*R. Pse me kryqin tënd të
shenjtë e shpërbleve botën
mbarë.*

Jezu Krishti bie për së dyti
nën kryq, që të na çojë ne
prej mëkatit. I dhembin varrët, por më fort papendimi
ynë dhe madhështia bëjnë që të lodhet. Përulë
madhështinë dhe krenarinë tënde, o njeri, dhe bëhu
zemerbutë e i përvuajtur.

Lutja: Jezu Krisht i dashur, ti përsëri po rrezohesh nën
barrën e kryqit, që të na çojsh prej mëkatëve. Na e
shndërit mendjen të kuptojmë sa e keqe e madhe
është mëkati dhe të ruhemi gjithmonë prej tij. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

N'mal t'kalvarit kur e lëshoi
Vehten n'kryq, e kur mbaroi
Krishtin pau e dhimbshmja Zojë.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT VIII

Jezu Krishti ngushllon gratë

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Gratë e përspirtshme të Jeruzalemit, kur panë Jezu Krishtin ashtu të vuajtur, filluan të qajnë. Krishti u tha: Bijat e Jeruzalemit, mos më qani mua, por qani veten dhe fëmijet tuaj! Edhe ne na thotë Krishti: Qani veten dhe mëkatet tuaja.

Lutja: Jezu Krisht i dashur, që më fort do t'i qajë mëkatet e mia se sa dhembjet tua, më ndihmo të pendohem përnjëmend me gjithë zemër dhe të rrëfehëm mirë, kështu që të pajtohem me Ty njëherë e përgjithmonë. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Deh ti Nana me dashtni
Dhimbe tande ban ta ndi
Sa t'jetoj n'ket shekull të zi

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da,
gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT IX

Jezu Krishti bie të tretën
herë nën kryq

*V. T'adhurojmë, o Krisht, e
të bekojmë.*

*R. Pse me kryqin tënd të
shenjtë e shpërbleve botën
mbarë.*

Për së treti Krishti po
rrëzohet nën kryq dhe
përsëri çohet të kryej
veprën shpërblimtare të veten. Duaje edhe ti kryqin,
sepse në të është shpëtimi dhe jeta.


Lutja: Jezu Krisht i dashur, po të lutemi për mundimet
tua, mos na lër në mëkate tona, por bën që të
kuptojmë rëndësinë e vdekjes sate, dhe me ndihmën
tënde ta shëlbojmë shpirtin tonë. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Tuj t'u lutë gjithmonë po shkoj,
Ban që Krishtin ta adhuroj,
Hirin tand kurr mos ta lëshoj.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT X

Jezu Krishtin e zhveshin

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Jezu Krishti si doli në Kalvar, salvuesit e zhdeshen. ç'mjerim! I

zhveshur faqe mundesve rri Krishti, Zot e njeri. E përse? Që të shpërblejë mëkatet e krenarisë dhe të grykësisë sonë.

Lutja: Jezu Krisht i dashur, sa shumë vuan ti për mëkatet tona. Të zhveshën që të shpaguash krenarinë tonë, dhe të dhanë të pish tëmth dhe uthëll për të shpërblyer grykësinë tonë; bën, po të lutemi, që edhe ne të zhveshemi prej krenarisë sonë dhe të jemi të matur në ushqim dhe në pije. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Nana e dashtun, t'lus pa pra
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da, gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT XI

Jezu Krishtin e
gozhdojnë në kryq

*V. T'adhurojmë, o Krisht,
e të bekojmë.*

*R. Pse me kryqin tënd të
shenjtë e shpërbleve
botën mbarë.*

Të mendojmë se si
gozhdët e rrahura me
çekiç i shporrojnë duar

dhe këmbë Jezu Krishtit dhe ngulen thellë në dru! Sa
dhembje e madhe do të ketë qenë! E pra ai veproi
vetëm mirë. Mendo atëherë çka do të meritoshë ti?


Lutja: Jezu Krisht, e si mundemi ne të shikojmë të
mbërthyer në kryq, e mos të largohemi prej mëkateve
tona? Sa ndëshkime të rrepta meritojmë për mëkatet
e gjertanishme. O Jezus, na e jep fatin që të pendohemi
me gjithë zemër. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Ti pjestar m'ban përgjithmonë
N'at mundim që për faj tonë,
hoq mbi kryq Shëlbuesi jonë.

*Nana e dashtun, t'lus pa pra,
varrët e Birit tënd pa da
Gjurma në zemër me m'i ba.*



TË NDALURIT XII

Jezu Krishti vdes në kryq

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Në dhimbje të pamasë Jezu Krishti qëndron i mbërthyer në kryq, e salvuesit nuk pushojnë duke e poshtëruar dhe duke e përqeshur. Megjithatë ai nuk i nem, po lutet për ta: "Fali, o Atë, se nuk dinë ç'bëjnë!" A i falë ti armiqtë tu? Jezusi, pas tri orë mundimesh të rënda, si bërtiti me zë të madh, dha shpirtë. E përse gjithkëtë? Për të na shëlbuar ne, që po endemi dita ditës larg tij.


Lutja: Jezu Krisht i dashur, ti vdiqe në mundime shumë të rënda dhe përsëri na shtrinë dorën që të pajtohesh me ne. A nuk do të marrim dorën e pajtimit tend? Po, o Jezus, e për këtë punë po biem në të dy gjunjët para kryqit tënd dhe me tërë fuqinë e shpirtit, të penduar, po të lutemi: Ki mëshirë për ne, e mos lejo që të ndahemi prej teje. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Afer krygj's t'Birit t'Tenzot, M'ban, O Zojë, me derdhun lot, dersa t'kemi jetë e mot.

Nana e dashtun, t'lus pa pra, varrët e Birit tënd pa da, gjurma në zemër me m'i ba.



TË NDALURIT XIII

Jezu Krishtin e ulin prej kryqit

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Jezu Krishtin e ulën prej kryqit dhe e vurën në prehën të Nënës së vet, Zojës së bekuar. Kush mund të kuptojë krejtësisht dhembjen e Nënës, e cila ka në prehën trupin e vdekur të vetmit djalë?

Lutja: O Zojë, Nënë tejet e dhembshur, për dhembje të madhe të zemrës sate dhe varrët e Birit tënd, na nxjerr hirin t'i qajmë me lot mëkatet tona dhe të kthehemi kah Zoti ynë. Bën, o Zojë, të vdesim në hirin shejtnues dhe të shëlbohemi. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

Afer krygjet tue gjimue,

Afer tejet tue lotue.

Kish të kjajë unë pa pushue.

Nana e dashtun, t'lus pa pra,

varrët e Birit tënd pa da

Gjurma në zemër me m'i ba.



TË NDALURIT XIV

Jezu Krishtin e varrosin

V. T'adhurojmë, o Krisht, e të bekojmë.

R. Pse me kryqin tënd të shenjtë e shpërbleve botën mbarë.

Jozefi prej Arimateje dhe Nikodemi i dhanë nderimin e fundit trupit të Jezu Krishtit, duke e varrosur në një varr të ri, ku deri atëherë nuk ishte varrosur askush. Por, korpi i Krishtit nuk ndenji gjatë në varr, sepse të tretën ditë Jezusi bashkoj shpirtin dhe korpin: lumturisht është ngjallur duke dëshmuar kështu hyjninë e vet.

Lutja: Jezu Krisht i dashur, fitues i vdekjes e dhënës i jetës: po të adhurojmë pors i Zot, Bir i amshuar i Atit të amshueshëm. Ti po na thua: "Ejani tek unë ju, që jeni të lodhur dhe të mbetur prej barrës së mëkateve, dhe unë kam për t'ua kthyer shëndetin, paqen dhe jetën me gëzime". Ja, pra, ne po vijmë, dhe mos lejo që të ndahemi më kurrë prej teje. Amen.

Lavdi Atit... - Si ka qenë...

Mëshirë, o Zot, për ne. - Mëshirë për ne.

O Zojë Virgjin, Nanë e dliërë,


Lute Zotin të ketë mëshirë:

Ti shëlbim prej si na nxier.

Nana e dashtun, t'lus pa pra, varrët e Birit tënd pa da, gjurma në zemër me m'i ba.

Urata përfunduese

O i dashuri Jezu Krisht, po të falënderojmë për hire që na ke dhënë me këtë përkushti. Pranoje, pra, në nderim të mundimeve të tua, për shpërblim të mëkateve tona dhe për freskim të shpirtave të Purgatorit. Mos lejo, o Jezu Krisht, që gjaku i derdhur i yti të shkojë për ne kot, por na jep hiret tua, që pas kësaj jete të vijmë për të gëzuar në amshim. Amen.



LUTJE KUSHTUAR ZOJËS SË BEKUAR



Maria, nëna jonë

Shenjtja Mari, tregohu ndaj nesh Shenjtja Mari, tregohu ndaj nesh si një nënë e mëshirshme dhe na prano si bijtë e tu. Mbretëreshë e qiellit dhe e tokës, Nëna jonë, tek ti po vijmë dhe po të lutemi të na e japësh bekimin tënd. Ti e zgjedhur nga Zoti dhe e bekuar mes grave, na e nxjerr hirin nga Jezu Krishti, Biri yt, që të shërbejmë ty gjithmonë këtu mbi tokë, në mënyrë që një ditë të pranohemi pranë teje në qiell. Amen.

O Zoja ime, o nëna ime

O Zoja ime, o Nëna ime. Para teje po e sjell krejt vetveten, dhe për ta shfaqur ty dhurimin tim, po t'i kushtoj sot ty sytë e mi, veshët e mi, gojën time, zemrën time dhe gjithë vetveten time. Prandaj, o Nënë e mirë, pasi unë të përkas ty, më ruaj si pasuri dhe pronësi tënden. Amen.

E tejetshenjta dhe e papërlyera Zemra e Marisë

Zemër e shenjtë dhe e papërlyer e Marisë, strehë e mëkatarëve, lutu për ne! E njohur, e dashur, e lavdëruar, e nderuar, e lëvdur dhe e lumturuar qoftë tani, kudo dhe në çdo kohë Zemra hyjnore e Jezusit dhe Zemra e papërlyer e së tejetlumturës Virgjërës Mari. Mari, Nënë e Hyjit, Mbretëreshë e qiellit, derë e parrizit, ti je një gëzim i veçantë i botës! Ti ke ngjizur Jezusin, Krijuesin dhe Shpëtimtarin, në të cilin nuk dyshoj. Lutu për ne tek Jezusi, Biri yt, që e ke ngjizur nga Shpirti Shenjtë dhe që ka lindur nga ti. Amen.

Lutje kushtuar Zojës në muajin maj

“O Zojë, Ti që je Mbretëresha e botës, të lutemi të na duash me gjithë shpirt. Sot, më shumë se kurrë kemi nevojë për dashurinë tënde. Toka, që e shkele ti vetë, është e mbushur me trishtim, varfëri, mëri, luftë, dhunë, frikë për të sotmen e për të nesërmen. Mbroji ata që, të tronditur nga vështirësitë e jetës a të ligështuar nga vuajtjet, i lëshon zemra e pushtohen nga dëshpërimi. Shndriti ata, që nuk i do askush, sepse nuk dinë të duan. Jepu dashuri, nga dashuria jote. Ngushëlloji ata, që janë shkëputur nga shokë e miq, sepse vdekja u ka trokitur para kohe tek porta a pse kanë humbur aftësinë ta kuptojnë njëri- tjetrin, duke e ndjerë veten thellësisht të vetmuar. Pajtoji njerëzit, që qajnë bijtë e humbur, bijtë e paudhë, bijtë e papunë, të pafat, të mjerë. Mëshirë, o Zojë, për prindërit, që nuk janë në gjendje të çojnë në shtëpi bukën e përditshme. Jepu zemër të fortë, që të mund

ta përballojnë jetën me durim, që të mund të presin ditë më të mira. Duaji ata, që Zoti u ka dhënë hijeshi e ndjenja fisnike, që të mos i shpërdorjnë këto dhanti për punë të kota, por t'i venë në shërbim të lumturisë së njerëzve, të cilët nuk i gëzojnë këto të mira. Duaji, o Zojë, edhe të gjithë ata, që nuk na duan!

LITANITË E ZOJËS

O Zot ki mëshirë. O Krisht ki mëshirë. O Zot ki mëshirë.

O Krisht ndjena ne. O Krisht dëgjona ne.

Ati qiellor, Zot, ki mëshirë për ne.

Bir, Shpëtimtar i botës, Zot, ki mëshirë për ne.

Shpirti Shenjtë, Zot, ki mëshirë për ne.

Shenjta Trini, i vetmi Zot, ki mëshirë për ne.

Shenjta Mari, lutu për ne.

Shenjta nëna e Tënzot,

Shenjta Virgjëra e virgjërave,

Nëna e Krishtit,

Nëna e Kishës,

Nëna e hirit të hyjnueshëm,

Nëna e kulluar,

Nëna krejt e pastër,

Nëna e papërlyer,

Nëna e paprishur,

Nëna e dashur,

Nëna e mrekullueshme,

Nëna e këshillit të mirë,

Nëna e Krijuesit,

Nëna e Shëlbuesit,

Virgjëra e nderueshme,
Virgjëra e lavdëruar,
Virgjëra e pushtetshme,
Virgjëra e mëshirshme,
Virgjëra besnike,
Pasqyrë drejtësie,
Selia e dijes,
Shkaku i gëzimit tonë,
Visar i përshpirtshëm,
Visar i nderueshëm,
Visar i zgjedhur përshpirtërie,
Trandofilja e mrekullueshme,
Kulla e Davidit,
Kulla e fildishtë,
Shtëpia e artë,
Arka e besëlidhjes,
Dera e qiellit,
Ylli i mëngjesit,
Shëndeti i të sëmurëve,
Streha e mëkatarëve,
Ngushëllimi i të pikëlluarve,
Ndihma e të krishterëve,
Mbretëresha e engjëjve,
Mbretëresha e patriarkëve,
Mbretëresha e profetëve,
Mbretëresha e apostujve,
Mbretëresha e dëshmorëve,
Mbretëresha e dëshmitarëve,
Mbretëresha e virgjërave,
Mbretëresha e të gjithë shenjtërve,
Mbretëresha e zënë pa mëkat të rrjedhshëm,
Mbretëresha e ngjitur në qiell,

Mbretëresha e shenjtës rruzare,
Mbretëresha e paqes,
Mbretëresha e familjeve,

O Qengji i Zotit, që shlyen mëkatet e botës,
na fal ne o Zot.

O Qengji i Zotit, që shlyen mëkatet e botës,
dëgjona ne o Zot.

O Qengji i Zotit, që shlyen mëkatet e botës,
ki mëshirë për ne.

Nën mbrojtjen tënde po ngasim o shenjtja Nëna e Hyjit, mos na i përbuz lutjet ndër nevoja tona, por, o Virgjëra e lume dhe e bekuar, na shpëto përherë prej të gjitha rreziqesh, Zoja jonë dhe ndërmjetëse e jona. Me Birin tënd na pajto, Birit tënd na porosit, ndër duar të Birit tënd na lësho.

Lutu për ne, o shenjtja Nëna e Hyjit.
Të bëhemi të denjë për premtimet e Jezu Krishtit.

Të lutemi: Jepna ne shërbëtorëve të tu, po të lutemi, o Zot, ti gëzohemi përherë shëndetit të shpirtit dhe të trupit, e nëpër ndërmjetësi të së madhërishmes dhe gjithmonë virgjërës Mari, t'i shpëtojmë trishtimit të tashëm dhe t'i gëzohemi gazmendit të amshuar.
Nëpër Krishtin, Zotin tonë. Amen.



SHËN JOZEFIT

O Shën Jozef, ki për mua e për ata që i kam të dashur, dashurinë që ke pasur për Jezusin e për Marinë: më prano në shtëpinë e Zotit si pjesëtarë të familjes tënde; më ndihmo të njoh, shërbej e të dua Jezusin e Marinë si i ke njohur, shërbyer e dashur ti. Në fundin e jetës, m'i hap dyert e qiellit. Amen.

SHNA NDOUT NDËR TË MARTE

O i lumi i mrekullueshmi shenjti Shna Ndue, gjithë bota e dëshmon madhërinë tënde. Të mëdhenj e të vegjël, pleq, të pasur, e të papasur të gjithë i tregojnë hiret e shumta e të mrekullueshme, që kanë nxjerrë prej Zotit nëpër lutje tua. E kushtet, që lëhen përpara figurës sate si nderim ngadhënjimi, dhuratat që rrethojnë e stolisin përherë lterin tënd, a se bëjnë dëshmi pushtetin tënd e fuqinë e lutjeve tua para të Lartit Zot?

Edhe ne, pra, po vijmë sot të përbysemi ndër këmbë të tua e të porosisim një punë, që ne kemi për zemër sa kurrnjë tjetër. Ne e dijmë se jemi mëkatarë të mëdhenj e nuk meritojmë që t'i sjellish sytë e tu të

dashur prej nesh, por, denjohu të këqyrësh me sy të dhembshëm mjerimin, në të cilin gjendemi. Po vijmë, pra te ti e duke shpresuar në mbrojtje tënde, po të lypin hiret që dëshirojmë. Deh, bën që mos të thuhet, se njerëz të shkretë, si jemi ne, kemi ardhur te ti e nuk na i ke plotësuar lutjet tona. Por bën që edhe ne të bashkohemi me tjerët për të lumturuar e për t'u falënderuar. Amen.



TË LUMES NËNËS TEREZË



O Hyj, Ti e thirre të lumen Terezë virgjër, t'i përgjigjej dashurisë së Birit tënd të etur në kryq me një dashuri të thellë për më të varfrit ndër të varfër; bëj po të lutemi, që me ndërmjetësinë e saj, t'i shërbejmë Krishtit në vëllezërit tanë që vuajnë.

Ai me ty jeton e mbretëron në bashkim me Shpirtin Shenjt, Hyj, për të gjithë shekujt e shekujve. Amen.

SHENJTËRIT KRYENGJËJ DHE ENGJËJ

Thirrja në ndihmë e kryeengjëjve

O shenjti kryeengjëll Mëhill!

Ti prirës i ushtrisë qiellore, ti fitues i dragonit të ferrit, ti ke marrë nga Hyji forcën dhe pushtetin për të shkatërruar me përvujtëri, krenarinë e pushtetit të errësirës! Na ndihmo t'ia arrijmë përvujtërisë së vërtetë të zemrës, besnikërisë së paluhatshme në kryerjen e vullnetit të Hyjit, forcës në vuajtje dhe në vështirësi! Na ndihmo që të jemi të qëndrueshëm para Katedrës Gjykuese të Hyjit!

O shenjti kryeengjëll Gabrieli!



Ti engjëll i Mishërimit, ti lajmëtar besnik i Hyjit, hapi veshët tanë edhe ndaj qortimeve dhe thirrjeve më të lehta të Zemrës dashuriplote të Zotit tonë! Na rri

gjithmonë para syve, që ta kuptojmë siç duhet Fjalën e Hyjit, t'i shkojmë pas dhe t'i bindemi asaj si dhe të bëjmë atë që Zoti do nga ne! Na ndihmo të qëndrojmë zgjuar në gatishmëri, në mënyrë që kur të vijë Zoti, të mos na gjejë duke fjetur!

O shenjti kryeengjëll Rafael!

Ti lajmëtar i dashurisë së Hyjit, plagose zemrën tonë me Dashurinë e zjarrtë dhe mos lejo kurrë që kjo plagë të shërohet, në mënyrë që ne edhe në përditësi të qëndrojmë në rrugën e Dashurisë dhe që në sajë të dashurisë të mund të fitojmë mbi gjithçka!

Përmbajtja

Viti i Mëshirës Hyjnore	>> 2
Zoja e Këshillit të Mirë	>> 4
Bekimi i shtëpive dhe familjeve	>> 6
Lutja e bekimit	>> 11
Lutjet themelore	>> 13
Shpirtit të Shenjtë	>> 17
Lutja e mëngjesit	>> 18
Lutja e mbrëmjes	>> 19
Lutja para bukës	>> 20
Lutja pas bukës	>> 20
Lutja Familjes së shenjtë	>> 20
Shpirti i Krishtit	>> 22
Rruzarja e shenjtë	>> 23
Udha e Kryqit	>> 27
Lutje kushtuar Zojës së Bekuar	>> 43
Litanitë e Zojës	>> 45
Lutja e Shën Jozefit	>> 48
Lutja Shna Ndout ndër të marte	>> 48
Lutja e së lumes Nënës Terezë	>> 50
Shenjtërit kryengjëj dhe engjëj	>> 51

* * * * *


Misioni Katolik Shqiptar

Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern

Tel: 041 250 52 60 Fax: 041 250 52 67

E-mail: mksh-lu@bluewin.ch; www.misioni-lu.ch

(Ad usum internum)



*Kisha e Shën Mihillit në Luzern
Pranë saj zyra e Misionit*